



## **U R D H Ë R**

**Nr. 180, datë 26.12.2018**

### **PËR**

### **NGRITJEN E GRUPIT NDËRINSTITUCIONAL TË PUNËS PËR PËRGATITJEN E PLATFORMËS SË PROGRAMEVE TË EMISIONEVE TË POSAÇME PËR MËSIMIN E GJUHËS SHQIPE, KULTURËN SHQIPTARE DHE IDENTITETIN KOMBËTAR, TË DEDIKUARA PËR DIASPORËN**

Në mbështetje të pikës 3, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 12, të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të pikës 5, të vendimit nr.690, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Diasporën,

### **U R D H Ë R O J:**

1. Ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për përgatitjen e platformës së programeve të posaçme për mësimin e gjuhës shqipe, kulturën shqiptare dhe identitetin kombëtar, të dedikuara për diasporën, në zbatim të pikës 5, të vendimit nr.690, datë 14.11.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën”.
2. Grupi ndërinstitucional i punës të kryesohet nga ministri përgjegjës për diasporën dhe të ketë në përbërje:
  - ministri përgjegjës për arsimin anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për arsimin anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për kulturën anëtar;
  - zëvendësministri në ministrinë përgjegjëse për punët e jashtme anëtar.



3. Në përbërje të këtij grupi pune ftohen të marrin pjesë:

- zëvendësministri përgjegjës për turizmin;
- drejtori i Përgjithshëm i Radiotelevizionit Shqiptar;
- përfaqësues i Akademisë së Shkencave;
- titullari i Agjencisë Kombëtare të Diasporës;
- përfaqësues i Fakultetit të Historisë dhe Filologjisë në Universitetin e Tiranës.

4. Grupi ndërinstytucional i punës duhet të mbledhet rregullisht nga ministri përgjegjës për diasporën, si dhe me iniciativën e përfaqësuesve të institucioneve të tjera.

5. Çdo institucion përgjegjës i përmendur në këtë urdhër do të angazhojë pranë grupit ndërinstytucional të punës specialistët e fushës për realizimin e qëllimit të përcaktuar në pikën 1, të këtij urdhri.

6. Ngarkohen titullarët e institucioneve përgjegjëse që, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri, të caktojnë përfaqësuesit e tyre në grupin ndërinstytucional të punës.

7. Ngarkohen ministri i Shtetit për Diasporën, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Kulturës dhe Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**